



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



P R O C E S V E R B A L

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 17.12.2019, me fillim në ora 10:00. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t’ju përvendosur të gjithëve, Nënkyetarin **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtore të drejtive, përfaqësuesit e KFOR-it, OSBE-së, të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm. Faleminderit shumë për pjesëmarrjen, e hapim mbledhjen e 12-të të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë:

R E N D D I T E

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Raporte rrreth aktiviteteve të KKSB-së për vitin 2019,
3. Shqyrtimi i Planit të Veprimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2020,
4. Shqyrtimi i Propozim Vendimit paraprak për shpalljen e interesit të përgjithshëm për hapjen rrugës publike në Z.K-Xërxe,
5. Raport i punës së Kuvendit të Komunës së Rahovecit për vitin 2019,
6. Shqyrtimi i Draft Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Rahovecit për vitin 2020,
7. Raporti mbi realizimin e Planit për vitin 2019 si dhe Shqyrtimi i Planit të punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2020,
8. Raporti mbi realizimin e Planit për vitin 2019 si dhe informatë mbi Planin vjetor të Zyrës së Prokurimit Publik për vitin 2020,
9. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për vënien në debat publik të Planit Lokal për veprim në Mjedis 2019-2024,
10. Të ndryshme.

Pikë Shtes

1. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për vënien në debat publik të Plani komunal për Eficiencë të energjisë në komunën e Rahovecit,

Kryesuesi – Të nderuar anëtarë të KPF-së, më kërkesë të Drejtorisë për Shërbime Publike na ka ardhur edhe një kërkesë që të kemi edhe një pikë shtesë për këtë mbledhje e cila është: **Plani komunal për Eficiencë të energjisë në komunën e Rahovecit**, meqenëse ky plan na është kthyer pozitivisht nga Ministria me datë: 12-të dhe nuk kemi mundur ta kemi të gatshëm për mbledhje të Kuvendit, nëse ju pajtoheni ta keni edhe këtë pikë shtesë. Faleminderit, a jeni që ta kemi edhe këtë pikë shtesë. Tani e hedhim në votim rendin e ditës me pikën shtesë. Konstatoj se unanimisht aprovohet rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar – A ka dikush diçka rrreth procesverbalit?

Fehmi Cena – Faleminderit Kryesues, përshëndetje për juve, Nënkyetarin, për kolegët këshilltarë, drejtorët, mediat, monitoruesit. Unë kam një vërejtje të vogël, një ndërhyrje të vogël në procesverbal, faqe 4 te diskutimi i Fehmi Cena diku ka mesi, jemi të vetëdijshëm gjithashtu se ky komunitet i ka shënuar disa hapa karshi Komitetit, unë mendoj që unë e kam cekur se disa hapa prapa se në atë kuptim kam dashur ta them, se ky komunitet është disa hapa prapa, prandaj ne e përkrahim këtë plan d.m.th. ajo fjalë mungon sepse i jep kuptim në të kundërtën i jep një kuptim tjetër pastaj, këtë vërejtje të vogël e kisha. Faleminderit!

Rasim Fazliu – Faleminderit Kryesues, përshëndetje për juve, Nënkyetarin, anëtarët e KPF-së, drejtorët, përfaqësues të KFOR-it, OSBE-së, medieve dhe gjithë kolegë këtu që janë të pranishëm. Unë gjithashtu jam te diskutimi im faqe 4, ku për një shkronjë i ndërrrohet kuptimi i fjalës dhe merr tanë kuptim tjetër që po e lexoj fjalinë që është ka fundi aty, aty shkruan prandaj është mirë me ju dal në ndihmë d.m.th. me heq shkronjën (n) sepse nuk është njëjtë fjalë sikur dalë pra e humb kuptimin, një shkronjë por ka ndërruar krejtësisht kuptimin e fjalisë. Faleminderit shumë!

Kryesuesi – Faleminderit, atëherë nëse nuk ka tjetër dikush, konstatoj se aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Raporte rreth aktiviteteve të KKSBS-së për vitin 2019 –

Fatmir Iska – Faleminderit i nderuar kryesues, anëtarët e KPF-së dhe gjithë ju të pranishëm. Është raporti i punës për gjashtë mbledhjet pra është minimumi i mbledhjeve që i mban KKSBS-ja, ne jemi vetëm ne seancën e gjashtë që kemi mbajtur, nga takimet konkluzat të cilat janë nxjerrë zakonisht pikat e rendit të ditës janë pothuajse të njëjta pra analizohet gjendja e sigurisë së përgjithshme në territorin e komunës tonë pastaj siguria në shkolla, në trafik, në sezonin dimëror gjithashtu jepen sqarime po ashtu edhe në sezonin veror pra në bazë të planit diskutohen të gjitha gjërat këtu. Për me tutje konkluzat janë aty mund t'i lexojmë por i kemi edhe pikën tjetër pra planin e punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi që e kemi mbajtur edhe një takim publik ku gjithë bashkërisht me anëtarët e KKSBS-së e kemi bërë edhe atë plan. Ajo çka ne kërkojmë është se vetëm ta pasurojmë planin e punës ndoshta edhe punë të tjera që mund të hyjnë në interes të komunës tonë. Faleminderit!

Rasim Fazliu – Faleminderit Kryesues, e falënderoj Nënkyetarin për prezantimin e kësaj pike edhe këtu desha me i bë unë disa pyetje, faqe 3 që po thotë që është bërë një ndezje e qëllimshme e objekteve të Komunës, pyetja ime është se a është identifikuar personi tash më vonë për me ditë kush e ka shkaktuar atë zjarr për vendin ku ka ndodhur rasti pra atje lartë te Maja e Shkodranit. Gjithashtu në faqe 6 kemi disa konkluza që i keni sjell këtu por unë pyetjen e kam kështu, tani për tani duke u bazuar në të gjitha irrethanat a ka veprimitari të lojërave të fatit ne komunën tonë pasi siç e dimë ato janë të ndaluara me ligi pra a keni verifikuar ndonjë vend në komunën e Rahovecit që zhvillohen lojërat e fatit, po ashtu desha me pyet kur jemi të ambienti pra ruajtja e ambientit e kemi fjalën te shtrati i lumbit Drin, eksplorativi i zhavorrit ku është konkretisht a është ende duke u eksploruar zhavorri në shtratin e lumbit Drini i Bardhë edhe gjithashtu përvèç shtratit ne jemi dëshmitarë pastaj edhe nëpër ara ndodhin këto gjëra sepse i japid njerëzit arat, ja shet zallin kështu që ndodhë një prishje e ambientit pra një shkatërrim i mjedisit edhe si qëndron puna rrëth kësaj. Po ashtu në faqen e fundit që e kemi gjithashtu këtu disa gabime gjuhësore që ndoshta meqenëse është dokumente zyrtarë është mirë me i përmirësuar po ashtu edhe ne faqen e parafundit te komandanti i Policisë z. Fazli Morina ka thënë kemi p.sh. fjalia e dytë apo e tretë ku shkruan këtu: ka konstatuar se gjendja e sigurisë në muajin tetor dhe nëntor ka qenë e qetë dhe stabile, po ashtu ka konstatuar nëse bëhet krasimi me dy muajt e vitit të kaluar pra është mirë me zëvendësuar me këto sigurisht se do të ketë kuptimin pastaj ka pasur rrënje të krimít e në venë të fjalës rrënje me shkruar rënje nëse keni menduar ashtu, a nëse krimi ka pasur rrënje prë keni aluduar në atë atëherë është krejt diçka tjetër pra kemi edhe gabime tjera por ndoshta për shkak të kohës mos të shkojmë me tutje. Ju faleminderit!

Fehmi Cena – Faleminderit Kryesues, edhe unë kisha diçka me dhënë mendimin tim rrëth këtij rapporti të punës nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, mendoj që është një raport megjithatë gjithëpërfshirës dhe sa kam vërejte çështjet të cilat janë shqyrtau gjatë mbledhjeve pra gjatë aktivitetit të këtij këshilli kanë qenë çështje me të vërtetë çështje që janë në interes të qytetarëve mirëpo ajo çka kisha kërkuar së paku në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të kemi sqarime pak më tepër me disa çështje, sepse këtu çështjet të cilat janë diskutuar, pra janë në rregull, mirëpo te konkluzat nuk janë të përfshira të gjitha p.sh. mua po më

intereson për qentë endacakë që është një interesim i gjithë qytetarëve si po shkon menaxhimi i kësaj, nuk përmendet askund edhe kisha dashtë sot ose në mbledhjen e ardhshme ndoshta është në interes të gjithëve që të gjithë delegatët të informohen si menaxhohet çështja e qenve endacakë në komunën tonë duke e ditur se ajo formë e vjetër e vrasjes së tyre tani nuk po lejohet, është forma tjetër pra deri ku ka arritur komuna janë, si po veprohet në këtë drejtim sepse ne po i shohim, se nuk është se nuk kemi qen endacakë, pra kemi mjaftë, e një raport më të hollësishëm me na dhënë kush është më kompetentë, trottuaret, lirimi i tyre, shenjat sinjalizuese është një çështje me të vërtetë brengë për qytetarët e komunës sepse në qytet ne kemi trottuaret që janë të zëna me gjëra të cilat nuk do të duhet me qenë të zëna, nuk po shoh ndonjë ndryshim të madh në këtë drejtim nëse krahasojmë këtë vit me vitin e kaluar përsëri nuk ka ndonjë ndryshim, a është punuar dhe sa po punohet në këtë drejtim pra edhe për këtë me na dhënë një informatë më tepër. Këto çështje tjera si siguria nëpër shkolla, unë besoj që drejtori i Arsimit do të jetë në gjendje të na sigurojë një informatë më të hollësishme dhe në fund të fundit ne e dimë se ai po i prezanton raportet 3-mujore çdo herë, por diçka më e hollësishme sepse është në interes të të gjithëve. Këto çështje kisha kërkuar që në mbledhjen e ardhshme të kemi pakës një sqarim më të mirë rrëth disa çështjeve të raportit. Faleminderit!

Kryesuesi - Pasi nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatoj se kalon për kuvend pika dytë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Planit të Veprimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2020 – Fatmir Iska – Pra është një plan siç e përmenda edhe para kësaj që është bërë në bashkëpunim me të gjithë anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi por edhe një takim i cili është mbajtur edhe me kryetarët e lagjeve e fshatrave d.m.th. është një plan që ka buruar aq sa kemi ditë të gjithë me dhanë kontributin tonë rrëth hartimit të këtij planit të veprimit, diçka tjetër nuk kam për të shtuar përpos që ju mundeni të diskutoni dhe pastaj me pasuruar nëse ka nevojë më tutje edhe në seancën e Kuvendit. Faleminderit!

Florida Bajraktari – Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë, këtë plan të veprimit e kam lexuar me vëmendje dhe shoh që nga viti në vit kemi rritje të shqiptimit të gjobave në trafik, kemi edhe aksidente me fatalitet, a ka ndonjë ndryshim në planin lokal të veprimit për vitin 2020 që do të ndikonte në zvogëlimin e aksidenteve dhe numrin e shqiptimit të gjobave në trafik. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit, atëherë pasi që nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatoj se kalon për Kuvend pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Propozim Vendimit paraprak për shpalljen e interesit të përgjithshëm për hapjen e rrugës publike në Z.K – Xërxe

Afrim Oruqi – Faleminderit Kryesues, i nderuar Nënkyetar, të nderuar anëtarë të KPF-së, para jush keni propozim vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm të pronës private e cila figuron në emër të tre bashkëpronarëve e cila gjendet në zonën kadastrale të Xërxe. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm është për hapje të rrugës sipas ligjit për vazhdimësi të procedurave tjera për këmbim ose për shpronësim të kësaj pjese, pasi që e njëjta po përdoret prej komunitetit që disa vjet. Faktikisht kjo rrugë është rrugë e hapur e kubëzuar, e kalueshme mirëpo është pronë private dhe pronari disa herë radhazi ka kërkuar nëpërmjet neve të kërkojmë shpronësim mirëpo ne nuk kemi pasur mundësi financiare dhe i njëjti ka bërë pengesë në qarkullimin e pronarëve tjerë kurse pronarët tjerë kanë kërkuar prej neve që me iniciuar këtë procedurë që me s'jell te ju, fillimisht me shpall zonë me interes të përgjithshëm dhe pastaj me vazhduar me procedura tjera. Ftoj kuvendarët pra anëtarët e KPF-së që pas shqyrtimit të miratojnë propozimin që të kaloj në Kuvend pika për shpalljen me interes të përgjithshëm.

Fehmi Cena – Faleminderit, për mos me zgjat më shumë veç kisha me pyet drejtorin si është menduar me u bo kompensimi, a do ta kompenson komuna në këtë rast, sepse ajo rrugë saktësish unë nuk e di a kanë qasje edhe të tjerët pra sa shtëpi, sa familje, a është rrugë e fshatit apo është rrugë vetëm e lagjes sepse këtu po përmenden emra të së njëjtës familje që do të lëshojnë mirëpo nuk e di të tjerët kush janë ata që e shfrytëzojnë këtë rrugë publike, thjesht kompensimi si do të bëhet shkurt. Faleminderit!

Afrim Oruqi – Faleminderit, për shkak të kohës ne nuk kemi parashtuar një imazh në projektor, bëhet fjalë për afér 2 ari e gjysmë e që janë me gjerësi prej 3 metra dhe diku mbi 100 metra që i bien afér 20 familje prona private kanë qasje në rrugë d.m.th. shtrirja e kësaj parcele është gjatësia e madhe dhe bëhet fjalë për një lagje që dy anët e rrugës kalojnë në të njëjtën. Ligji parashevë këmbim edhe shpronësim varësisht prej

juve qysh do të vendosni në të ardhmen, tash për momentin jemi në këtë fazë, ligji po thotë që para se me shpronësuar me të holla ose me tokë duhet me shpallë interes të përgjithshëm mandej prapë ju vendosni në seancat e tjera të radhës se cili është modaliteti-i këtij shpronësimi. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit drejtë, atëherë pasi që nuk kemi tjetër të lajmëruar, konstatoj se kalon për Kuvend pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Raporti i Punës së Kuvendit të Komunës së Rahovecit për vitin 2019 –

Kryesuesi – Të nderuar anëtarë të KPF-së, Kuvendi sipas planit të punës të cilin e kemi aprovuar vitin e kaluar ka mbajtur gjithsej duke përfshirë edhe mbledhjen e sodit për Politikë dhe Financa 12 mbledhje të rregullta gjatë këtij viti, gjithashtu kemi mbajtur seancë solemne ne Ditën e Pavarësisë me 17 Shkurt, kur është bërë edhe ndarja e çmimit qytetar nderi zotëri Xhevahir Spahiut. Gjithsesi puna e Kuvendit dhe puna e Komitetit për Politikë dhe Financa edhe për këtë vit i ka mbajtur të gjitha dëgjimet buxhetore kur ka paraparë kalendarin, orarin, kohën nëpër të gjitha vendbanimet për ti marr prioritetet e qytetarëve të komunës sonë.

Në të gjitha mbledhjet që i ka mbajtur Kuvendi i keni të gjitha në material më gjerësishët mirëpo të gjitha vendimet janë trajtuar gjatë këtij viti kemi: 6 rregullore, 9 plane, 43 vendime, 12 njofitime apo informata si dhe 8 raporte, ku ne total i kemi 78 akte të cilat gjithsesi janë të aprovuara edhe të miratuara edhe nga Ministria e Pushtetit Lokal ku prej tyre kemi 33 akte të cilat e kanë konfirmimin, janë edhe akte të tjera mirëpo sipas rregullores kur nuk kthehen nga MAPL-ja për 15 ditë dhe 5 ditë që duhet të dalin në gazetën zyrtare dhe ato me automatizëm aprovojen. Kemi pasur edhe dy vendime të cilat MAPL-ja na ka rekomanduar Kuvendit që t'i shqyrtojmë, të cilat sipas rekomandimeve të MAPL-së edhe Kuvendi i ka shqyrtuar edhe i ka trajtuar ato.

Ndoshta për më tepër, për shkak edhe të kohës në mbledhje të Kuvendit do të sqarohen më tepër. Faleminderit shumë!

Rasim Fazliu – Faleminderit Kryesues, fillimisht ju falënderoj për prezantimin e këtij raporti, është vërtetë gjithëpërfshirës pra i ka përfshirë të gjitha aktivitetet që janë bërë në Kuvend, edhe ne Komitetin për Politikë dhe Financa edhe të tjerët, por kisha dashtë që të jap kontributin pak para se të shkojë në mbledhje të Kuvendit, të përmirësohen disa gjëra ndoshta janë lëshime të rastit, janë bërë disa kombinime ndoshta edhe për shkak të asaj edhe ka ardhur deri ato lëshime, vazhdojmë ne faqe 2, fillimisht aty ceket bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale edhe statutin e komunës së Rahovecit në planin e punës së Kuvendit të Komunës dhe rregulloren e punës së kuvendit kemi kënaqësi të paraqesim para jush reportin 6-mujor d.m.th. aty me hekë sepse bëhet fjalë për plan vjetor, edhe me poshtë u cek se është periudha janar-dhjetor 2019 d.m.th. të hiqet ajo 6 mujori, në mënyrë që për mbledhje të kuvendit të jetë më në rregull. Pastaj kemi ne faqe 3 kemi gjithashtu fjalia e parë, Kuvendi duhet të mbaj së paku dhjetë (10) mbledhjeve në vit d.m.th. të hiqet ajo -venë fund pra duhet të jetë së paku 10 mbledhje në vit, këto janë formale por për kuvend i bëjnë mirë, pastaj kemi të Komitetet e Kuvendit të Komunës desha të bëj një pyetje ku thuhet se Komunitetet konsultative ndihmëse, desha me ditë se sa komitete konsultative ndihmëse janë themeluar dhe kanë qenë aktive brenda kësaj kohe edhe me sqarua këtë punë, pastaj ne faqe 4 ne fund ku thuhet se komitetet konsultative i kemi veç dy fjali edhe s'kemi ceke më tutje, pastaj dalim në faqe 14 gjithashtu në tabelën e mëposhtme e kemi fjalinë ku pasqyrohet në të dhënat statistikore për zhvillimin dhe ecuritë në Komitetin për Politikë dhe Financa të Komunës së Rahovecit për periudhën e dymbëlljet (12) mujorin e parë, kështu që fjala dymbëdhjetë mujorshe të bëhet dymbëdhjetë mujorit të parë, pastaj kemi të përmisohen për Kuvend këto, gjithashtu faqe 15 kemi dëgjimet buxhetore për vitin 2020 Kryesues, ne e dimë qe në vitin 2020 ende s'kemi nuk kemi hyrë pra ky paragraf tërhiqet krejt ose të përmirësohet pra të jetë 2019 për shkak se kemi edhe me poshtë ka mesi i këtij shkrimi është Kuvendi Komunal në Rahovec në ora 14 më pastaj ka mbajtur edhe dhjetë takime tjera sipas kalendarit. Ne kalendarin e vitit 2020 kanë qenë parapara të mbahen dhjetë dëgjime publike me qytetarë, gjithashtu të jetë për vitin 2019, pastaj vazhdojmë faqe 17 e kemi çështjet e diskutuara në Kuvend, aktet e kuvendit të Komunës unë veç po i përmendi disa jo të gjitha por disa gabime gjuhësore dymbëdhjetë mujore pra një është mirë me qit aty dymbëdhjetë, pastaj kemi mbi tabelë aty fjalia siç mund të shihet nga tabela për këtë periudhë dymbëdhjetë gjithashtu mungon, Kuvendi i Komunës ka nxjerr këto lloj aktesh pra duhet të jetë këto lloje aktesh, pra veç po i përmendi disa prej tyre në mënyrë që të jetë dokumenti më i komplektuar. Faleminderit kryesues!

Kryesuesi – Faleminderit shume z. Fazliu për kontributin, gjithsesi do të përmirësohen edhe këto gabime teknike, te Komitetet konsultative për momentin komuna jonë ka vetëm një komitet konsultativ meqenëse kishte dështuar edhe formimi i komitetit konsultativ për shërbimet publike nuk ishin të paraqitur askush dhe konkursi ka dështuar. Nëse nuk ka tjetër, konstatojmë që kalon për Kuvend pika e pestë e ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i Draft Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Rahovecit për vitin 2020 –

Edhe për këtë pikë, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politike dhe Financa, ne me datën 5 të këtij muaji kemi mbajtur një punëtori në bashkëpunim me organizatën e OSCE-së, të cilën së bashku e kemi hartuar Planin e Punës për Kuvendin. Atëherë nëse dikush nuk ka diçka për të thënë, konstatojmë se kalon për Kuvendë edhe pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Raporti mbi realizimin e Planit për vitin 2019 si dhe shqyrtimi i Planit të punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2020 –

Ruzhdi Kabashi – Përshëndetje Kryesues, përshëndetje Nënkyetar dhe gjithë ju pjesëmarrës të pranishëm. Në bazë të planit vjetor për vitin 2019 të njësisë së Auditimit të Brendshëm kemi pasur të planifikuara 10 auditime të rregullta. Më kërkesë të Kryetarit kemi bërë edhe 2 auditime ad hoc për disa drejtori tjera kështu që të gjitha këto auditime janë përfunduar, 11 janë të finalizuara me raporte, kurse vetëm te Zyra e Prokurimit është përfunduar auditimi, mirëpo ka mbetur vetëm përgatitja e raportit që brenda kësaj jave besoj që kryhet edhe raporti i kësaj zyre. Nga gjithsej 12 auditime të kryera për vitin 2019, kemi 38 rekomandime pa këtë të fundit për Zyrën e Prokurimit d.m.th. 39 rekomandime janë dhënë për 11 auditime. Vazhdojmë me **Planin Vjetor** i paraparë për vitin 2020. Ne si njësi e auditimit kemi përgatitur planin vjetor të punës për vitin 2020 që është aprovuar dhe nënshkruar edhe nga Kryetari i Komunës. Në vija të trasha po e ceki se auditimi i parë është drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrotje të Mjedisit, auditimi i dytë është paraparë për Punët Inspektuese, auditimi i tretë është Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, auditimi i katërt është drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, auditmi i pestë është drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim, auditimi i gjashtë është drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, auditimi i shtatë është Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Komunale, auditimi i tetë është Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, auditimi i nëntë është Drejtoria për Financa dhe Buxhet dhe auditimi i dhjetë është Zyra e Prokurimit, pra gjithsej dhjetë auditime janë të planifikuara për vitin 2020. Faleminderit!

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, unë e falënderoj zyrtarin njësisë së Auditimit të Brendshëm për paraqitjen e planit vjetor të punës për vitin 2020 edhe është mirë që na ka prezantuar këtu por rreth këtij plani nuk kam për të shtuar diçka gjithçka është në rregull mirëpo veç presim tash të kryhen punët gjatë vitit 2020, por fjalën që e mora është krejt diçka tjetër. Është e kotë me na prezantua neve një plan të punës të Auditorit të Brendshëm në qoftëse Kryetari i Komunës gjatë viteve nuk na sjell punën që e kryen Auditori i Brendshëm, për me ditë se çka po ndodh në komunën tonë, cilat janë aktivitetet, a ka mangësi diçka, çka mundemi me bë, minden të ftojnë edhe si anëtarë për Politikë dhe Financa por edhe si anëtarë të Kuvendit Komunal. Pra plani do të ishte hiq kurrgjë nëse Kryetari i Komunës vazhdon mos me na prezantuar aktivitetin, punën, te gjeturat, te gjitha çka i bën Komiteti për Auditim të Brendshëm. Faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit z.Fazliu, atëherë nëse nuk ka tjetër dikush të lajmëruar, kalon për Kuvend edhe pika e shtatë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Raporti mbi realizimin e Planit për vitin 2019 si dhe informatë mbi Planin vjetor të Zyrës së Prokurimit Publik për vitin 2020 –

Fatmir Iska – Faleminderit Kryesues, pra janë zhvilluar 82 aktivitete të prokurimit vlera e parashikuar është mbi 20 milion, deri me tanë janë të nënshkruara 86 kontrata dhe vlera e nënshkrimit të kontratave është 7,759,758 euro, dy aktivitete pra procedura të prokurimit janë anuluar pastaj janë rishpallur ato ndërsa 8 janë në procedurë të prokurimit. A ka shkuar e gjithë kjo në bazë të planit të prokurimit, unë nuk po them jo, do të thotë ka arsyet përdryshme p.sh. një aktivitet i prokurimit është paraparë me u shpall në prill ndërsa ai ka ndodhur në qershor përsye të caktuara që mund të jetë mungesa e projektit me kohë apo arsyet të tjera, nuk jam shumë i sigurt se është zbatuar plani në përpikëri sipas muajve ndërsa aktivitetet e prokurimit të gjitha janë zhvilluar sipas planit qysh e kemi paraparë. Në tabelar i kemi gjitha kontratat që nga momenti i shpalljes së aktivitetit të prokurimit pastaj njoftimet për kontratat, dhënie të kontratës, nënshkrimit, vlerës së

parashikuar të shpalljes së aktivitetit të prokurimit, aneks kontratave, çmimin e kontratës dhe në fund e kemi edhe vlerën e gjitha kontratave të nënshkruara.

Nga aktivitetet e prokurimit që kemi 82 pastaj edhe kontratat që i kemi 86 dhe dikush mundet të thotë se pse i kemi 82 aktivitet ndërsa kontrata i kemi më tepër, këto janë sipas lotove d.m.th. një aktivitet i prokurimit zhvillohet ndërsa kemi 2 apo 3 lote të dy apo tre operatorë d.m.th. në një aktivitet të prokurimit kemi dy kontrata ose tre eventualisht d.m.th. kjo është vetëm sa një sqarime pastaj edhe në Kuvend do të diskutojmë këtë, ku do të jetë edhe ushtruesi i detyrës i menaxherit të prokurimit publik. Faleminderit!

Fehmi Cena – Në fakt kur jemi te ky raport vjetor, Nënkyetari e sqaroi që nëse ka shkuar sipas planit, edhe ne e kemi vërejtur se nuk kane shkuar bash sipas planit mirëpo me intereson kjo se nuk kanë shkuar edhe aktivitetet këtu nuk figurojnë disa aktivitetet d.m.th. është planifikuar që kemi edhe shumën mirëpo nuk është kryer aktiviteti, pra, këtu duhet me pa një sqarim në mbledhjen ardhshme të Kuvendit, të ceket nuk është kryer, pse nuk është kryer, a është në vazhdimësi e sipër pra janë disa prej tyre p.sh. po e lexoj një mirëmbajtje dhe servisimi i instrumenteve muzikore në shkollën e muzikës „Faik Sylka“, në Rahovec që janë të parapamë 4,400 euro po asgjë nuk shkruan më tutje pra një arsyetim të shkurtër për Kuvend mendoj se duhet të kemi këto sqarime sepse është një raport që ne duhet me ditë gjithçka që ka ndodhur. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit z. Cena, atëherë pasi nuk ka të tjerë të lajmëruar, konstatojmë se kalon për Kuvend pika e tetë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për vënien në debat publik të Planit Lokal për Veprim në Mjedis 2019-2024 –

Bjondina Ramaj – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, përshëndesim kryesuesin edhe anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa. Unë këtu kam dal sot që të bëj shqyrtim propozimin e vendimit për vënien në debat publik të Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2019-2024. E keni të gjithë planin përrpara, kemi kohë edhe vërejtjet edhe sugjerimet me kohë edhe t'i irregullojmë edhe t'i zbatojmë. Është një plan që u dashtë qysh më herët ta kemi, e kemi punuar, është grapi punues që ka punuar rrëth këtij plani edhe shumë me rëndësi se është një plan shumë detal edhe i ka shume pika që është mirë që ne t'i realizojmë për vitet në vazhdim. Nëse ka dikush diçka, ky është vetëm shqyrtim për debat publik.

Kryesuesi – Nëse nuk ka dikush diçka për të thënë atëherë konstatojmë se kalon për Kuvend pika e nëntë e rendit të ditës, e kemi edhe pikën shtesë: Plani Komunal të Veprimit për Eficiencë –

10. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për vënien në debat publik të Plani komunal për Eficiencë të energjisë në komunën e Rahovecit.

Bjondina Fazliu – Siç e ceku edhe Kryesuesi më herët, kjo e ka ardhur pak me vonesë si pikë, mendoj se plani i Eficiencës për energji është një plan shumë i mirë që në të ardhmen do të na sjell disa të dhëna që ne i kemi pasur mangu deri me sot, sa i përket ajrit, Eficiencës nëpër shkolla, thjesht është një plan që është punuar shumë mirë në bashkëpunim me GIZ-in që e kemi, në mënyrën me të mirë të mundshme. Sa i përket edhe ndotjes së ajrit siç e cekëm edhe dje që ishte një lajm, se ndotja e ajrit ke me e madhe në komunën tonë por nuk do të thotë që ishte gjatë gjithë kohës por vetëm një vlerë normale gjatë mbrëmjes, mendoj që do të jetë plan shumë komplet dhe i mirë sa i përket vendit dhe që na ka munguar neve si Komunë. Faleminderit shumë!

Kryesuesi – Faleminderit shume zonja. Fazliu, atëherë nëse nuk ka dikush diçka rrëth kësaj pike, konstatoj se kalon për Kuvend. Faleminderit shumë.


11. Të ndryshme .

Fatmir Iska – Te këto gabimet drejtshkrimore, definitivisht unë pajtohem se do të merrem me këtë sepse Komuna ka angazhuar një punëtore pra lektore për këto punë edhe sinqerisht ju them se nuk është mirë të vij dokumenti në këtë nivel që me i trajtuar ju si anëtarë të KPF-së por edhe si anëtarë të Kuvendit, pra mund të ndodhin gabime por jo në nivelin si është dokumenti këtu sepse të gjithë janë zyrtare dhe nuk është e ndershme me i publiku ku qytetaret e komunës dhe të Republikës së Kosovës me i lexuar këto në web-faqe.

Kryesuesi – Faleminderit Nënkyetar, të nderuar anëtarë të KPF-së, faleminderit shumë për kontributin tuaj dhe mirëkuptimin e juaj. Shihemi në mbledhjen e radhës. Faleminderit!

Mbledhja përfundoi në 10:45

Prosesmbajtësi,


Agim Hoti

